



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE

V E N D I M

NR. 8, DATË 15/ 07/ 2025

PËR

**DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 25/5, DATË 15.12.2020 TË
KOMITETIT TË INVESTIMEVE PËR PROJEKTIN E INVESTIMIT
STRATEGJIK “SAN PIETRO”**

Në mbështetje të nenit 9, nenit 18 dhe 22 të Ligjit Nr. 55/2015, “Për Investimet Strategjike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Kreu II, pikës 8 të VKM-së Nr. 1026, datë 16.12.2015 “Për vlerësimin e dokumentacionit të investimeve strategjike”, si dhe bazuar në Vendimin e Komitetit të Investimeve Strategjike Nr. 25/2, datë 20.11.2017 “Për miratimin e statusit strategjik ‘Investim/Investitor Strategjik, Procedurë e Veçantë’ për projektin e investimit strategjik San Pietro”, Vendimin e Komitetit të Investimeve Strategjike Nr. 25/5 datë 15.12.2020 dhe Vendimin e Komitetit të Investimeve Strategjike Nr. 25/15 datë 06.06.2023, Komiteti i Investimeve Strategjike, me propozim të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA),

VLERËSOI:

- Komiteti i Investimeve Strategjike me Vendimin Nr. 25/2, datë 20.11.2017, ka vendosur miratimin e statusit strategjik për projektin “San Pietro”, me subjekt “Concord Investment shpk”, me NIUS/NIPT K81602049K.
- Subjekti investues ka përfituar statusin e veçantë “Investitor në strukturë akomoduese me 5 vje, status special”, miratuar me VKM Nr. 300, datë 10.5.2019 “Për dhënien e statusit të veçantë ‘Investitor në Strukturë Akomoduese me 5 vje’, Status Special”, aplikuesit “Concord Investment” shpk.
- Subjekti investues është pajisur me Vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit Nr.13, datë 28.02.2020 “Për miratimin e rishikimit të kushteve të lejes së ndërtimit të miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar 2 të Territorit Nr.16, datë 27.04.2018, për objektin “Ndërtimi i kompleksit turistik San Pietro, Komuna Ishëm, Qarku Durrës”.

- Me qëllim asistimin e subjektit për nevoja të mëtejshme lidhur me realizimin e projektit të investimit, Komiteti i Investimeve Strategjike me Vendimin Nr. 25/5, datë 15.12.2020, ka miratuar shtyrjen e afatit të statusit miratuar me Vendim të Komitetit të Investimeve Strategjike Nr. 25/2, datë 20.11.2017.
- Në përfundim të realizimit të strukturës akomoduese turistike dhe kolaudimit të veprës, Komiteti i Investimeve Strategjike me Vendimin Nr. 25/15, datë 06.06.2023, ka miratuar në parim masën mbështetëse të së drejtës së përdorimit të brigjeve dhe zonës përkatëse të plazhit përballë projektit të investimit strategjik me një afat 30 (tridhjetë) vjeçar.
- Miratimi përfundimtar i masës mbështetëse të së drejtës së përdorimit të brigjeve dhe zonës përkatëse të plazhit përballë projektit të investimit strategjik, u realizua me VKM-në nr. 519, datë 01.08.2024 dhe kontrata u nënshkrua me Bashkinë Durrës.
- Subjekti ka kërkuar vënien në dispozicion të pronës shtet, me një sipërfaqe prej rreth 2.1 ha vetëm për arsye rekreacioni dhe argëtimi, si kërkesë e brandit. Pas verifikimeve kadastrale rezultoi se vetëm sipërfaqja prej rreth 1 ha, sipas gjurmës në Aneks 1 të këtij vendimi, e cila prek pasuritë: nr. 145/3 dhe nr. 145/9 në ZK 2375, është shtet dhe potencialisht e mundur për t'u vënë në dispozicion.

Në përfundim, pasi u njoh me gjithë dokumentacionin e nevojshëm,

KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 25/5, datë 15.12.2020 të Komitetit të Investimeve Strategjike, pika 1 ndryshohet si më poshtë vijon:

“Shtyrjen e afatit të Statusit “Investim/Investitor Strategjik Procedurë e Veçantë” për projektin e investimit strategjik “San Pietro”, i cili po realizohet nga subjekti “Concord Investment shpk”, NUIS/NIPT: K81602049K për një periudhë 1 (një) vjeçare.

2. Në vendimin nr. 25/5, datë 15.12.2020 të Komitetit të Investimeve Strategjike, në vijim të nenit 2, pika c, shtohet pika d, si më poshtë vijon:

Miratohet, në parim, masa mbështetëse konsolidim toke, si dhe vënie në dispozicion e pasurisë së paluajtshme, në pronësi të shtetit shqiptar, në funksion të projektit strategjik. Në zbatim të nenit 27 të Ligjit Nr. 55/2015, i ndryshuar, dhe Kreut II të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 1030, datë 16.12.2015, miratimi përfundimtar i kësaj mase mbështetëse të vënies në dispozicion të pronës shtetërore, për realizimin

e investimit strategjik, do të rregullohet sipas parashikimeve të një vendimi të posaçëm të Këshillit të Ministrave. Ky i fundit, i propozuar nga ministria përgjegjëse për ekonominë, do të parashikojë kalimin e pronës shtet, pjesërisht nga pasuritë me nr. 145/3 dhe nr. 145/9 në ZK. 2375, me sipërfaqe totale rreth 1 (një) hektar, në Fondin e Pasurive të Paluajtshme në Mbështetje të Investimeve Strategjike (FPPMIS), sipas gjurmës së përcaktuar në Aneksin 1 të këtij vendimi.

Ministria përgjegjëse për ekonominë, do të duhet të realizojë verifikimet e nevojshme me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës me qëllim konsolidimin e kësaj prone shtet dhe lidhjen e kontratës së qirasë me subjektin investues me objekt mundësimin e së drejtës së përdorimit të kësaj pasurie si një zonë mbrojtëse me gjelbërim dhe hapësira sportive dhe argëtuese për fëmijë pranë strukturës akomoduese, pa parashikuar asnjë ndërtim në këtë gjurmë.

3. Pika 3 e vendimit nr. 25/5, datë 15.12.2020 të Komitetit të Investimeve Strategjike ndryshohet si më poshtë vijon:

“Në rast se përgjatë zhvillimit dhe zbatimit të projektit investues strategjik “San Pietro” konstatohen të dhëna të pavërteta, të rreme apo ndryshime të të dhënave të dala rishtazi, mbi bazën e të cilave nuk do të ishte vendosur për miratimin e statusit strategjik të këtij projekti me procedurën e veçantë, Komiteti i Investimeve Strategjike, ka të drejtë të anulojë vendimin për dhënien e statusit strategjik.”

4. Pika e 6 e vendimit nr. 25/5, datë 15.12.2020 të Komitetit të Investimeve Strategjike ndryshohet si më poshtë:

“Ngarkohet Agjencia Shtetërore e Kadastrës të kryejë ndarjen e pasurive të paluajtshme shtetërore në përputhje me gjurmën e përcaktuar në aneksin nr. 1 të këtij vendimi, rikonfigurimin si dhe regjistrimin e pasurive të reja të përfuara në përputhje me qëllimin e këtij vendimi.”

5. Ky vendim publikohet dhe regjistrohet në Regjistrin e Investimeve Strategjike dhe i njoftohet kërkuarit nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, në rolin e saj të Sekretariatit të Komitetit të Investimeve Strategjike.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KOMITETIT TË INVESTIMEVE STRATEGJIKE

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU

MINISTËR I EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT

BLENDI GONXHJA

MINISTËR I FINANCEVE

PETRIT MALAJ

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT

MIRELA KUMBARO

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

ANILA DENAJ

AVOKATI I PËRGJITHSHËM I SHTETIT

ODISE MOÇKA

SEKRETARIATI TEKNIK I KIS

LAURA PLAKU (SARO)